



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe të nenit 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, të dt. 10. 09.2003, nenit 3, par. 1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b, dhe të nenit 40 par.3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më. 15.08.2005 merr

V E N D I M

PËR EKSPOZIMIN E PROJEKTEVE IDEORE TË FAZËS SË PARË TË PLANIT RREGULLATIV PËR LAGJEN “ULPIANA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ekspozimin e projekteve ideore të fazës së parë të Planit rregullativ për lagjen “Ulpiana” në Prishtinë.

Faza e parë e Planit, nga al. 1 e këtij neni, është zgjidhja ideore dhe hartimi i projektit zbatues për kompleksin në mes të rrugëve “Bulevardi i Dëshmorëve” dhe “Imzot Nikë Prela”, i emërtuar si “Qendra- Ulpiana”

Projektet ideore, nga par.1 i këtij neni, paraqesin zgjidhjet ideore, ndërsa projekti ideor, i përzgjedhur nga Komuna, do të jetë bazë për hartimin e projekti zbatues për realizimin e kompleksit, nga par. 2 i këtij neni.

Neni 2

Projektet ideore, sipas këtij Vendimi, do të ekspozohen për shikim publik.

Ekspozimi për shikim publik i projekteve ideor, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese, pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Organizimin e ekspozimit për shikim publik të projekteve ideore, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të ekspozimit për shikim publik të projekteve ideore, sipas këtij Vendimi, organet kompetente komunale dhe Komisioni i caktuar për vlerësim, do të kryejnë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e projektit të zgjedhur ideor, në mënyrë që, i njëjti, t’i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 35-19432, më. 19.08.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri